



Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel Drini



info@kmshc.al



www.kmshc.al

05 Dhjetor 2024

# NJOFTIM

## MBI PJESËMARRJEN E INSTITUCIONIT TË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL NË TAKIMIN E ORGANIZUAR NGA MINISTRI I SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN LIDHUR ME ZBATIMIN E VENDIMEVE/REKOMANDIMEVE TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA

Më datë 4 dhjetor 2024, Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, si ndërlidhëse e bashkëpunimit ndërinstitucional mes Kuvendit të Shqipërisë, Qeverisë dhe institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, organizoi një takim me përfaqësues të nivelit të lartë të këtyre institucioneve dhe drejtues të Projektit PACEP për vlerësimin e ecurisë së procesit të monitorimit dhe zbatimit të rekomandimeve të nxjerra prej tyre në ushtrim të veprimtarisë në zbatim të ligjit. Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues të Komisionerit për Mbiqëqyrjen e Shërbimit Civil.

Ky takim theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për adresimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit të rekomandimeve/vendimeve, dhe nevojën për një metodologji të standardizuar për monitorimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve/vendimeve.